

VENDIM
Nr. 400, datë 1.6.2016

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK TË BASHKIMIT EVROPIAN, ME MISION TRAJNUES, NË REPUBLIKËN E MALIT, NË AFRIKË¹

(Ndryshuar me VKM nr.413, datë 10.5.2017; nr.247, datë 9.5.2018)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 103/2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për krijimin e kuadrit për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionet e menaxhimit të krizave të Bashkimit Evropian”, të neneve 3, pika 3, 6, pika 5, e 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të Bashkimit Evropian, me mision trajnues (EUTM Mali), si pjesë e Grupit EOD, në mbështetje të Kompanisë së Ruajtjes së Bazës dhe në ekipin e “Task-Forcës së Stërviçjes”, në Koulikoro, në Republikën e Malit, në Afrikë, me përbërjen, si më poshtë vijon:

- a) 3 ushtarakë për periudhën 8 qershor - 17 nëntor 2016;
- b) 4 ushtarakë për periudhën 17 nëntor 2016–31 dhjetor 2019.

2. Misioni i ushtarakëve që do të marrin pjesë në operacionin ushtarak të Bashkimit Evropian është mbështetja dhe dhënia e kontributit në funksione të ndryshme EOD në Kompaninë e Ruajtjes së Bazës dhe në ekipin e “Task-Forcës së Stërviçjes”.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në datën 31 dhjetor 2019. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me përfaqësuesin e radhës.

4. Venddislokimi i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është në bazën e operacionit ushtarak të Bashkimit Evropian, në Koulikoro, në Republikën e Malit, në Afrikë.

5. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesë-marrës në këtë operacion, përballon shpenzimet, për:

- a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;
- b) sigurimin e jetës;
- c) siguracionin shëndetësor jashtë zonës së operacionit;
- ç) mbështetje shëndetësore;
- d) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;
- dh) transport;
- e) transportimin e individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disiplinë;
- ë) aktivitete social-kulturore, në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;
- f) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

¹ VKM nr. 400, datë 1.6.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.99, datë 8 qershor 2016.
VKM nr.413, datë 10.5.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.110, datë 16 maj 2017.
VKM nr.247, datë 9.5.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.71, datë 17 maj 2018.

6. Transporti i personelit që do të shërbejë në Republikën e Malit ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanteria, transporti i individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje apo thyerjeje disipline do të përballohet nga pala shqiptare, përveç rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe, ku pala tjetër të marrë përsipër këto shpenzime.

7. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

9. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi